



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:030997
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05625782

P.nr.125/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorit profesional Izet Hyseni në çështjen penale kundër të akuzuarit: E. Sh. për shkak të veprës penale: Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5921/2021 e dt. 15.04.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 25.04.2024, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Menduhi Kastrati, të dëmtuarit Sh. B., si dhe të akuzuarit me mbrojtësen e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. F. M. në të njëjtin ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 26.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E. SH. nga i ati Sh. dhe nëna S. mbiemri i vajzërisë së nënës M., i lindur me datë, me vendbanim në fshatin B., Komuna e Podujevës, i gjendjes së dobët ekonomike-financiare, me numër personal të identifikimit:, ka të kryer shkollën e mesme, profesioni punëtor privat, i pa martuar, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 01.09.2021 në Podujevë, i pandehuri që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, ka organizuar, dhe marr pjesë lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, në atë mënyrë që i njëjti ia kishte shitur të dëmtuarit Sh. B. programin “Bet 365”, m.sporti7777 në shumë prej 5000 euro ku i dëmtuari ia kishte dhënë shumën prej 3000 euro në këmbim të instalimit të programit-lojës së fatit bastores sportive ku si pasoj i dëmtuari kishte humbur para në shumë prej 5000 euro duke përdorur këtë program.

- me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale *Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 2 i KPRK-së.*

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, dhe nenit 294 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 368, 369, 449 dhe 452 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

- I. Të akuzuarin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim do të ekzekutohen brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- II. Pas shpalljes së aktgjykimit, gjykata konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimi me burgim, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 500.00€ (pesëqind/euro), i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.
- III. Nëse i akuzuari nuk e paguajnë dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do të llogaritet 1(një) ditë burg.
- IV. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.
- V. I dëmtuari Sh. B., ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore – juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.5921/2021 e dt. 15.04.2024, kundër të akuzuarit E. Sh. për shkak të veprës penale *Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 2 të KPRK-së.*

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më datë 25.04.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Menduhi Kastrati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të dëmtuarit Sh. B., si dhe të akuzuarit me mbrojtësen e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokates F. M.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: E pranoj fajësinë, është e vërtetë si në aktakuzë, ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë, sepse çfarë do dënimi do ta rëndonte gjendjen time ekonomike, pasi që jam i pa punë, mbajtës i familjes.

Mbrojtësja e të pandehurit avokate F. M. lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij deklaroi: Pas njoftimit të pandehurit lidhur me natyrën e pranimin të fajësisë, i njëjti në mënyrë vullnetare e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, nga gjykata kërkoj që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, si dhe rrethanat tjera lehtësuese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar dha mendimin: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, e njëjta është bërë me vullnetin e tyre të plot dhe në përputhje me dispozitat ligjore, i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, të pandehurin ta shpalli fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: Nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, nuk kërkon kompensim dëmi, tutje ka shtuar se me të pandehurin është shok dhe ka raporte të mira.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjtit është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprave penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 2 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penalo-juridik janë përgjegjës, për çka të njëjtit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se të akuzuarit gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, deklarimin e të pandehurit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se nuk kërkon kompensim dëmi, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit, të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burg është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.125/2024 me dt.26.04.2024

G j y q t a r i

Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.